



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 05.02.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Uran Ismaili (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

**Munguan:** Visare Gashi (PSD), Valbona Petrovci, e pavarur, Naime Osmani (LDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Osman Billaca** tha se është një propozimvendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për KFOR-in, gjegjësisht SHPI - KFOR "Film City", pra kjo pronë është dhënë edhe më herët, në vitin 2013, dhe vetëm kërkohet vazhdimi i shfrytëzimit të pronës.

**Halim Halimi** bëri vërejt rreth procedimit të kësaj pike, duke thënë se kjo do të duhej të sillej edhe në KPF dhe të shqyrtohej. Ne nuk jemi kundër dhënies së pronës në shfrytëzim KFOR-it, por ne jemi kundër mos zbatimit të procedurave.

**Shefki Gashi** tha se është dashtë të hyjnë në rend dite për diskutim edhe disa çështje të tjera, të cilat kanë qenë aktuale, siç janë: çështja e mos pastrimit të disa rrugëve, ku shumë prej tyre kanë qenë të bllokuara, pastaj mos vijimi i mësimit të nxënësve, ku plot tri javë nuk shkuan në shollë dhe Komuna e Prishtinës nuk e ka shprehur asnjë qëndrim, asnjë thirrje, asnjë lutje atyre njerëzve për të filluar procesi mësimor.

Është çështja e ujit, e cila ka qenë mungesë, përndryshe shumë vende kanë mbetur pa ujë. Po ashtu infrastruktura rrugore është në një gjendje shumë të keqe, gropat pothuajse janë evidente në shumë rrugë dhe Komuna absolutisht nuk po merret me sanimin e tyre.

Në emër të GP-së, propozoj që "Shkollës së Gjelbër" në Prishtinë t'i vihet emri i ish-drejtorit të ekzekutuar në Komunën e Prishtinës, z. Remzi Salihu.

**Fiknete Bejta** tha se më vjen mirë që z. Shefki Gashi paraprakisht i parapriu kërkesës time që sot të kemi një pikë të rendit të ditës të jashtëzakonshme, për votimin e propozimit tim, në koordinim me komunitetin e lagjes ku funksionon kjo shkollë, d.m.th. shkolla fillore "Shkolla e Gjelbër". Propozimin e mbështesim në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja "i" të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ku thuhet decidivisht se "Kuvendi mund t'i delegojë emërtimin dhe riemërtimin e institucioneve, shkollave, rrugëve të komunës përkatëse".

Propozimi im është që "Shkolla e Gjelbër", vetëm t'i shtohet emri Remzi Salihu, dhe të bëhet "Shkolla e Gjelbër, Remzi Salihu".

**Vlora Dumoshi**, në cilësinë e kryesueses së Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport, tha se duke parë gjendjen në arsim, grevat të cilat zgjatën tri javë, ne kemi mbajtur dy takime, ku ka marrë pjesë edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, edhe kryetarja e Këshillit të prindërve dhe arsimtarëve. Dua ta falënderohem shumë drejtorin e Arsimit, z. Jonuz Salihaj, i cili ka dhënë kontribut dhe ka qenë i gatshëm që çdo ditë të na informojë neve si Komitet.

Duke e respektuar iniciativën e GP-në e LDK-së për një njeri, për një intelektual të madh, siç ishte Remzi Salihu, ku kam pasur nderin edhe të punojë me të, duke ia njohur personalitetin si një njeri profesionist, modest, pavarësisht ndasive politike këtu që kemi, unë i ftoj të gjithë këshilltarët që ta votojmë dhe këtë ta procedojmë në Ministrinë e Arsimit, ku atje edhe do të merret vendimi për emërtimin e kësaj shkolle "Shkolla e Gjelbër, Remzi Salihu".

**Sami Boroci** theksoi se këto ditë kam pranuar një kërkesë, gjegjësisht jam takuar me disa përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta, të Prishtinës, dhe kam pranuar një kërkesë, me një propozim, që kjo shkollë të emërtohet me emrin e dëshmorit Shpend Canolli. Sa i përket biografisë së Shpendit, besoj se e dini të gjithë, është dëshmor, i cili ka dhënë jetën në luftën e fundit, është i anës së Gollakut.

Unë sot, me gjithë respektin për propozimin paraprak, kisha dashur që të trajtohet edhe ky propozim, sepse është kërkesë e Shoqatave të luftës.

Çështja e dytë ka të bëjë me Planin e mobilitetit. Si këshilltarë komunalë, kemi dëgjuar shumë për proklamimin e Planit të mobilitetit, mirëpo edhe përkundër premtimeve të shumta që kanë ardhur vitin e kaluar, është premtuar që kanë me ardhur në Kuvend. Unë ende nuk e di asnjë detaj të vetëm çka përmban ky Plan. Thuhet se ka me i zgjidhur shumë probleme të Prishtinës, mirëpo ende nuk është sjellë në Kuvend.

**Kryesuesi** u shpreh se propozimi për emër tjetër për shkollën e njëjtë, është propozim që do të futet në votim, ndërsa sa i përket njoftimit rreth Planit të mobilitetit, këtë pjesë do ta lë te pika "Të ndryshme", ose në ndonjë seancë tjetër, nëse janë të interesuar ta fusim si pikë "Njoftim i Kuvendit lidhur me dinamikën e Planit deri ku ka mbërrirë".

**Egzon Azemi** theksoi se në mbledhjen e fundit të KPF-së, të gjithë jemi pajtuar që pika për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Bashkësisë Islame, të rishikohet edhe një herë, për shkak se nuk është bërë ndarja si duhet. Edhe përkundër premtimeve që u dhanë nga drejtori i Drejtorisë së Pronës, ky material na ka ardhur pa u korrigjuar fare nga drejtorja. Na është sjellë dokumentacion i disa parcelave, në vend se të bëhet bashkimi i këtyre parcelave në një parcelë të vetme, gjegjësisht me e ndarë parcelën që po jepet në shfrytëzim. Andaj, kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, le të kryhet ashtu si duhet, sepse ky veprim në këtë formë nuk i ndihmon Bashkësisë Islame, e as Komunës së Prishtinës, sepse nesër prapë mundet me pasur konteste.

**Adrian Berisha**, në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, tha se propozimi për ndërrimin e emrit të Shkollës së Gjelbër u dha nga kryesuesja e komitetit. Unë fillimisht nuk jam kundër personit apo punës së tij, por gjithmonë jam që Shkollës së Gjelbër me i mbetur emri "Shkolla e Gjelbër", dhe për këtë pikë unë e kisha lexuar një pjesë të USAID-së, i cili është financues i Shkollës së Gjelbër.

" "Shkolla e Gjelbër" me iniciativën e USAID-së është ndërtuar si shkollë ekologjike, standard ky që plotëson kushtet për BE, që në fakt simbolizon objekt ekologjik, e ky emër e karakterizon objektin e shkollës sonë si të vetmen në rajon. Shkollë e tillë siç është Shkolla e Gjelbër, është e vetmja në rajon".

Andaj, propozoj që kësaj shkolle mos t'i ndërrohet emri.

**Jonuz Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se sa i përket çështjes së grevës, grevën në Arsim nuk e kemi organizuar ne, por e ka organizuar SBASHK, por ajo çka kemi bërë ne gjatë tërë kohës, kemi qenë në kontakt me drejtorët e të gjithave institucioneve

shkollare të komunës së Prishtinës, kemi diskutuar gjerësisht dhe e kemi mbështetur grevën, por nuk e kemi mbështetur kërkesën për me pësuar fëmijët. Greva ka qenë e papranueshme për neve, por mirë u bë që është zgjidhur ky problem. Sa i përket çështjes së emërimit të shkollave, çdo propozim është legjitim, por nuk është mirë me diskutuar për figura. Shoqatat e luftës kanë bërë kërkesë, me nënshkrime, që Shkolla e Gjelbër të emërtohet me emrin Shpend Canolli.

**Rifat Deri** tha se ka disa muaj, përafërsisht tetë muaj, prej kur kam propozuar që të themelohet një komision profesional, i cili do të merret me riemërtimin e rrugëve dhe institucioneve në komunën e Prishtinës.

Unë propozoj që para se të formohet Komisioni profesional, ju si kryesues, edhe ne, të mos japim propozime, për shkak se nuk e di a ekziston ende ai komisioni i vjetër, i cili, sipas mendimit tim dhe sipas mendimit të shumicës së njerëzve, ka punuar në mënyrë jo profesionale, nuk ka qenë në nivelin çfarë do të duhej të ishte një komision i tillë. Andaj, propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, të themelohet komisioni dhe komisioni profesional të bëjë vlerësimin për Shkollën e Gjelbër, apo për shkolla dhe rrugë të tjera që të marrin emërtime të merituar.

**Halim Halimi** tha se Kuvendi i Komunës nuk vendos për emërtimin e shkollave, ai komision të cilin e thotë Rifat Deri, është komision për emërtimin e rrugëve, shesheve, lagjeve e institucioneve, e jo të shkollave, d.m.th. nuk kemi nevojë të formojmë komision për këtë çështje.

Këtu ka dalë një iniciativë prej Komitetit për Arsim dhe Kulturë, edhe ajo iniciativa tjetër prej Shoqatave të luftës, mund të ketë edhe një iniciativë tjetër. Këto propozime i dërgohen organit kompetent për çështje të arsimit, ashtu si është e paraparë me Udhëzim administrativ, pra Drejtoria e Arsimit i dërgon tre emra në Ministrinë e Arsimit, pastaj Ministria e Arsimit e ka Komisionin profesional për emërtimin e shkollave.

**Migjen Shala** u shpreh se ne si Kuvend i Komunës mund të marrim vendim për propozimet e dhëna, pastaj propozimet dërgohen në Ministrinë e Arsimit, në mënyrë që ata të vendosin.

Çdo respekt për të ndjerin Remzi Salihu, e kam njohur edhe personalisht, kemi punuar bashkë, edhe iu ka ndihmuar luftëtarëve në atë drejtim, mirëpo propozimi i Shpendit, njeriu që ka vdekur me armë në dorë për atdhe duke e mbrojtur popullatën e Gollakut, bash të kësaj pjese, është diçka tjetër. Andaj, unë personalisht dëshmorin nuk e ndërroj me askënd.

**Drilon Pireva** e përkrahu propozimin e z. Deri, që do të duhej të ishte një komision i përbërë edhe prej asamblastëve, që t'i shikojë dokumentet relevante, kërkesat e banorëve, kërkesat e komunitetit përreth, por edhe për të bërë një vlerësim të personaliteteve që propozohen, kështu që ishte dashur me na u ofruar informacione shtesë prej atij komisioni profesional, duke i marrë edhe shumë faktorë për bazë.

Kërkesa e grupit tonë parlamentar është që të themelohet një Komision i përbashkët, ose së paku të trajtohen këto tema nga ana e këtij komisioni profesional.

**Agim Gashi** theksoi se nuk është mirë të bllokohen iniciativat, edhe pse ka konkurrencë në iniciativa, sepse Udhëzimi administrativ i krijon hapësirat për njëfarë konkurrence iniciativash.

Kuvendi nuk është i autorizuar që të marrë vendim, sepse nuk është kompetent. Kuvendi mund të votojë për iniciativën, hiq më shumë, dhe pastaj procedurat zhvillohen në harmoni me Udhëzimin administrativ, që e rregullon fushën e emërimit të institucioneve edukativo-arsimore.

**Eman Rrahmani** kërkoi që pika e tetë e rendit të ditës të tërhiqet, për shkak se drejtori, Dren Kukaj, nuk i ka marrë parasysh këshillat të cilat ia kemi dhënë në KPF dhe nuk e ka bërë prapë ndarjen e kësaj parcele para se t'i jepet në shfrytëzim Trafikut Urban, prandaj ne jemi dakorduar në KPF që të bëhet kjo ndarje, pastaj të jepet propozimi si parcelë e veçantë për dhënie në shfrytëzim.

Sa i përket emërimit të shkollave, besoj se kemi me pasur mjaft shkolla për t'u vendosur emrat, kështu që është mirë të pritët deri sa të përmbushen premtimet e Shpendit edhe ky problem ka me qenë shumë lehtë i zgjidhur.

**Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, u shpreh se sa i përket ndarjes së parcelave, janë objektivisht të pamundshme, për shkak se kopjet e planit qëndrojnë në Serbi. Ky është një problem i përgjithshëm, me të cilin ballafaqohet Komuna e Prishtinës dhe secila komunë e secili organ që merret me mbarëvajtjen e regjistrave kadastralë.

**Nol Nushi** tha se kjo formë e sjelljes së propozimeve në seancë në mënyrë kaq ad hoc, është komplet e çakorduar, e papranueshme, edhe është mos respekt për ata që po i propozoni, prandaj duhet pasur pak më shumë respekt për këto figura dhe me i trajtuar më seriozisht. Duhet me pasur një pajtim me njëri-tjetrin se cilët emra kanë nevojë me u ndryshuar, andaj është problem kështu me i vendosur emrat në garë me njëri-tjetrin. Pastaj, nuk ka Komisione profesionale të kësaj fushe për emërtimin e shkollave apo të rrugëve, andaj ju kisha lutur të jeni më të përmbajtur, që të mos përdoret kjo asamble për garë politike në këtë mënyrë.

**Adrian Berisha** propozoi që "Shkolla e Gjelbër" të emërtohet Sevasti Qiriazhi, e cila ka qenë mësuesja e parë e gjuhës shqipe.

**Kryesuesi** bëri të ditur se janë tri propozime për emërtimin e "Shkollës së Gjelbër" dhe i hedhim në votim për futjen në rend dite.

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 4 kundër dhe 4 abstenime, hyn në rend të ditës pika "Propozimi për emërtimin e Shkollës së Gjelbër në "Shkolla e Gjelbër, Remzi Salihu, "Shkolla e Gjelbër, Shpend Canolli", ose "Shkolla e Gjelbër, Sevasti Qiriazhi".**

**Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për SHPI- KFOR, "Film City", që të futet në rend dite.**

**Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 4 kundër, futet si pikë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për SHPI- KFOR, "Film City".**

Kryesuesi tha se është propozimi tjetër: "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës", që të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 11 vota për dhe 28 kundër, nuk kaloi propozimi për heqjen e pikës nga rendi i ditës: "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës", andaj mbetet në rend dite për shqyrtim.

Kryesuesi tha se është edhe propozimi tjetër: "Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë", që të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 12 vota për dhe 23 kundër, nuk kaloi propozimi për heqjen e pikës nga rendi i ditës: "Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë", andaj mbetet në rend dite për shqyrtim..

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua ky

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit";
3. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona";
4. Propozimrregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë, Bashkësisë Islame të Kosovës;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë;

7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortikultura";
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë;
9. Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018;
10. Diskutim për Raportin vjetor të punës së KKSB-së;
11. Propozimvendimi për emërtimin e SHFMU "Shkolla e Gjelbër": Remzi Salihu, Shpend Canolli ose Sevasti Qiriazhi;
12. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, në shfrytëzim SHPI-KFOR-it, "Film City", në Prishtinë;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratuan ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

#### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik në lagjen "Bregu i Diellit".**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se këtë propozimvendim sot po e hedhim prapë në votim, sepse po e shohim të rëndësishme këtë çështje. Në ndërkohë, i kemi pasur disa takime edhe me Rektoratin, pra me Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, dhe kemi konstatuar se ata punojnë në kushte shumë të vështira, andaj po kërkojnë zgjerimin e objektit të tyre. Ne kemi propozuar të jetë në pjesën e Fakulteti Teknik, në një sipërfaqe prej 9 hektarë, ku, në një të ardhme të afërt, do të trajtohej ndërtimi i të gjitha objekteve sipas kërkesës së Rektoratit.

**Halim Halimi** theksoi se tash e katër vjet sillet e njëjta gjendje rreth këtyre planeve rregulluese të hollësishme, por ne deri tani, d.m.th. prej vitit 2013 kemi mundur me e nxjerrë, me e sjellë dokumentin bazik, që është Harta zonale, të cilën e parasheh Ligji mbi planifikimin hapësinor, dhe çështja do të rregullohej e nuk do të kishte nevojë këtu as të diskutohet, por automatikisht do të merrej vendimi i tillë.

Ne e dimë se planet rregulluese të hollësishme duhet të bazohen në Planin zhvillimor komunal dhe në Hartën zonale. Është e vërtetë se Fakulteti i Shkencave Matematike-

Natyrore është në gjendje të rëndë, në gjendje të vështirë, e kur gjendja është e tillë, askush nuk është për ta penguar, por sikur viteve të kaluara, po e dimë deri diku që po votojmë diçka që nuk është e ligjshme. Por, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, duke e marrë parasysh gjendjen e Fakultetit, unë do të votojë kësaj radhe për, por besoj se edhe grupi im do të votojë.

**Vala Peshku** tha se duke u bazuar në informatat që i kemi pasur të ofruara nga drejtoria përkatëse, jemi për t'i kaluar pikën e dytë dhe të tretë.

**Egzon Azemi** shprehu mendimin se këto dy dokumente, plane rregulluese të hollësishme, nëse ne marrim tani vendimin për miratimin e tyre, gjasat janë shumë të vogla që ato të përfundojnë para shtatorit. Pra, në vendim për këto dy dokumente më të rëndësishme, që e paraqesin të gjithë planifikimin detaj të Komunës së Prishtinës, thuhet se përfundojnë në shtator. Atëherë, çfarë logjike ka me i bërë dy plane rregulluese të hollësishme për dy raste selektive, në rast se në shtator përfundon ky dokument! Cili është qëllimi me i bërë këto kërkesa në këtë formë dhe me na qitur në lajthitje të gjithë asamblistëve?! Unë, personalisht do të votoj për propozimvendimet, sepse në njërën anë është në pyetje Universiteti, e në anën tjetër janë në pyetje disa banorë që i keni gënjer me vite të tëra, e pse po i gënjeni ju e dini, sepse keni mundur me iu dhënë leje edhe me planin zhvillimor aktual, mirëpo nuk iu keni dhënë.

**Sami Boroci** u shpreh në përkrahje të miratimit të këtyre dy pikave, duke besuar se Harta zonale është në proces e sipër dhe së shpejti do ta kemi në trajtim edhe atë.

**Eman Rrahmani** theksoi se unë, personalisht, shumë herë e kam ngritur çështjen e Hartës zonale dhe të Planit zhvillimor, i cili ka ngecur dhe nuk është duke u bërë asgjë në të. Jam i sigurtë që sot këto dy propozime kanë ardhur për shkak se drejtori është tërhequr prej Hartës zonale dhe Planit zhvillimor, dhe ato dy projektet më të rëndësishme të Prishtinës nuk do të realizohen as gjatë këtij viti, as në gjatë mandati. Nuk ka kuptim logjik, këto propozime që vijnë secilën herë, nuk është plani i hollësishëm i parë apo i dytë ky, kemi pasur edhe dy apo tri plane të tjera të hollësishme të cilat kanë kaluar në këtë Kuvend. Po bëheni shkaktar i bllokimit komplet të Prishtinës, e keni bllokuar Prishtinën me hartimin zonal dhe planin zhvillimor.

Kjo qytetari me të vërtetë është jashtëzakonisht e shtypur nga ju, që për shkak të tekeve dhe të interesave personale, merreni me kësi punësh dhe hartime ad hoc të lagjeve të caktuara, ku keni interesa të caktuara. Kanë mbetur të gjitha lagjet e Prishtinës pa hartim zonal. Në momentin që i keni sjellë këto dy plane të hollësishme, atëherë e keni pranuar që ka dështuar hartimi zonal, për shkak se nuk ka shanse teorike me përfunduar këto dy plane para muajit shtator.

**Nol Nushi** shprehu mospajtim me diskutimin e parafolësit, duke thënë se nëse këto plane janë të interesave, restoranteve kriminale, unë nuk e kisha votuar, e ju po e votoni. Pse po e votoni nëse janë kriminale?! Nëse thua është interes kriminal me votuar një plan të tillë, ti e voton, qysh e voton, kush është kriminel këtu tash?! Kjo është e turpshme. Këtu jemi duke folur për çështje urgjente, që duhet pasur parasysh.



**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim, ku tha se sipas këtij propozimvendimi vërehet se po synohet zhvendosja e Universitetit prej kampusit të Universitetit. Hapësira te Universiteti ka vend për të gjitha fakultetet, kështu që me vetëdije apo pa te, me interes apo pa interes, po e zhvendosni prej pronës së Universitetit një Fakultet të Shkencave Matematike-Natyrore, apo cili do çoftë ai. Sipas kësaj, ju po e legjitimoni nxjerrjen e Universitetit prej lokacionit të vetë për hir të Kishës ortodokse dhe këtë ju nuk po e tregoni. Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

**Kryesuesi** konstatoi se më 30 vota për, 2 kundër dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona".**

**Shefqet Osmani** bëri vërejtje në propozimvendim, duke thënë se te neni 12, thuhet "Duhet të shfuqizohet vendimi 01035295598", ndërsa në sqarim të Ministrisë thuhet "Duhet të ndryshohet vendimi me numër tjetër 295958", d.m.th. janë dy vendime që nuk po përputhen mes veti.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimvendimin, me vërejtjen e dhënë për nenin 12, që të bëhet përmirësimi i numrit të vendimit.

**Kryesuesi** konstatoi se më 33 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona".

**Pika e katërt**

**Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.**

**Kryesuesi** konstatoi se më 26 vota për, u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës.**

**Kryesuesi** hapi diskutimin.

**Egzon Azemi** ngriti një shqetësim rreth këtij propozimvendimi, duke thënë se nuk po mundemi ta kuptoj qasjen e drejtorit, Drenit, se çështjet që po i ngremë po i merr me inat, prandaj është thjesht kërkesë, e që është e mundur me u bërë, ashtu si është bërë te Fakulteti Filozofik, te parkingu nëntokësor ku planifikohet dhe e njëjta procedurë mund të ndiqet edhe në këtë rast.

**Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, theksoi se unë i kam organizuar tri takime me të gjithë ata persona përgjegjës që janë marrë me këtë çështje, se bashkimi i asaj parcele mundet me u bërë edhe pas këtij votimi, nuk ka kurrfarë pengese juridike që mos me u realizuar.

**Vlora Dumoshi**, theksoi se ne jemi këtu për të marrë vendime, të cilat janë shumë të rëndësishme për qytetarët e komunës, po edhe arsytimi shpesh po na mungon. Në mungesë të një arsytimi të plotë, e që është dashur të jepet të paktën nga ndonjëri prej zyrtarëve profesionist, ne tani nuk dimë se si të votojmë, sepse nesër mund të jemi të atakuar me ndonjë padi. Andaj, bëj thirrje të ju kryesues i Kuvendit, që drejtorët le të vijin këtu, sepse kjo është papërgjegjësi totale.

**Agim Gashi** tha se rreth kësaj me të vërtetë kërkohet një sqarim më detal, sepse po shihet se ajo pjesë që do t'i jepet në shfrytëzim Bashkësisë Islame përbëhet nga disa parcela. Nëse ai parcelim është skicuar, është dashur që dikush të na tregoj dhe qysh qëndron juridikisht problemi, sepse nga praktika kur nuk janë detajizuar këto çështje, na ka dalë problem, siç ka qenë rasti me Katedralen, ku ju e dini se numri i parcelës së Katedrales i ka përfshirë edhe semaforët ekzistues! Prandaj, për të mos bërë gabime të tilla, duhet me u detajizu problemi, me u skicuar, me u sqaruar, me u ditur se sa metër katrorë jepen, sa pjesë iu kanë marrë secilës parcelë dhe a është formuluar drejt.

Po ashtu, ai shprehu edhe një shqetësim, duke thënë se ato janë varreza të qytetarëve të besimit Islam, aty mund të varrosen edhe njerëz të cilët nuk janë të disiplinuar në atë religjion skajshmërisht nuk i dëshirojnë ritet përkatëse, dhe Komuna është përgjegjëse edhe për atë kategori njerëzish. Në qoftë se një objekt i tillë i jepet decidivisht një institucioni, siç është Bashkësia Islame, po ua cenojmë të drejtën kategorisë së njerëzve të tjerë të cilët nuk e ndien veten ashtu.

**Dren Kukaj**, drejtor, tha se skica është përgatitur, e cila e precizon se cila pjesë e parcelës i jepte në shfrytëzim Bashkësisë Islame, duke pasur parasysh hapësirën që ata e kanë në shfrytëzim, mirëpo pa dokumentacion përkatës. Bashkësisë Islame në tërësi i jepet sipërfaqe për shfrytëzim hapësira prej 887 m<sup>2</sup>.

**Halim Halimi** tha se në vendim është dashtë të ceket sipërfaqja prej 887 m<sup>2</sup>. Pra, ky është vendim dhe kjo veç sa e begaton këtë.

**Shefki Gashi** theksoi se bashkimi i atyre parcelave pa kurrfarë dokumenti, pa kurrfarë historie, mendoj se është shkelje totale e ligjshme edhe juridike. Në mungesë të ortofotove, në mungesë të dokumentacionit origjinal, nuk guxojnë me e ndryshuar numrin e parcelës. Me ndarë një parcelë p.sh., 3, 4, 5/1, për 2, për 5, mundemi me i nda, por dy parcela me i bashku me një numër tjetër nuk guxojnë me e bërë.

**Vala Peshku**, shprehu mendimin se duhet me pasur sipërfaqe të tërësishme, sepse janë 4 parcela dhe prej se cilës është e ndarë nga një parcelë, andaj nuk ka nevojë me u cekur totali në fund.

**Shefqet Osmani** pyeti se a është arritur ndonjë marrëveshje mes ndërmarrjes "Hortikultura" dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, sepse nëse sot i bartet kjo pronë Bashkësisë Islame, atëherë ku do të mbesin pajisjet dhe mjetet të cilat i ka "Hortikultura", me të cilat bën edhe hapjen e varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre.

**Dren Kukaj** tha se sa i përket marrëveshjes mes Hortikulturës dhe Bashkësisë Islame, nuk kam ndonjë informacion konkret në lidhje me këtë, por e di se Drejtoria e Shërbimeve Publike është duke u marrë me këtë çështje.

**Vlora Dumoshi** theksoi se ndërtimi i atij objekti ka qenë më se i nevojshëm për qytetarët e Prishtinës, por fatkeqësisht ajo mbeti pa kujdes të plotë dhe dedikimi se pse është ndërtuar ai objekt, duket se qytetarët nuk e shfrytëzojnë. Tash këtu bie edhe një konflikt mes Hortikulturës, e cila ka qenë mirëmbajtëse e gjithë atyre varrezave, por edhe të objektit. Vendimin të cilin e merr Kuvendi do të duhej ta specifikonte, sepse ndërmarrje "Hortikultura" është organ i Komunës së Prishtinës dhe këtë duhet ta shikojmë me shumë kujdes, sepse në Hortikulturë kemi një pjesë të madhe të njerëzve që janë të punësuar dhe nëse shkon bartja te Bashkësia Islame, ne duhet menduar dhe kalkuluar çështjet, pra duhet ta analizojmë këtë çështje më mirë.

**Selim Pacolli**, nënkryetar, tha se ai objekt është në gjendje të tmerrshme dhe nuk është funksional. Aty as ndërmarrja "Hortikultura" nuk i ka pajisjet e veta. Hortikultura e ka një zyrë, mirëpo varrezat hapen me një ekskavator. Si i tillë, këtij objekti do të duhej caktuar një titullar. Në varrezat e Prishtinës nuk kemi parcela të parapara edhe ndoshta për atë kategori që nuk janë të disiplinuar në aspektin religjioz. Ne si Komunë e Prishtinës jemi të detyruar që tu garantojmë parcela ose hapësira për varreza, dhe e kemi në plan, në projekt që shumë shpejt do të vijmë para jush me ofrimin e një parcele për varreza shtesë. Ai objekt ka qenë i paraparë jo në aspektin religjioz, por ai ka qenë një objekt i cili i përshtatet të gjitha besimeve dhe nuk është i dedikuar vetëm për besimin islam.

**Eman Rrahmani** theksoi se ne nuk jemi kundër Bashkësisë Islame që ky objekt të jepet në shfrytëzim, mirëpo jemi kundër atyre parregullsive me të cilat po tentohet të kalohet ky propozimvendim.

Me propozimet e dhëna nga Halim Halimi dhe Vlora Dumoshi, kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për 1 kundër dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës.**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë.**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Shefqet Osmani** ngriti shqetësim, duke thënë se kompania "Pastrimi", derisa ishte drejtor Feim Salihu, kërkesën e ka bërë me 26.05.2018, ndërsa e njëjta kërkesë prej Trafikut Urban ka ardhur me 24.01.2019. Pse të bëhet ky selektim?! Derisa ka qenë drejtori përfaqësuesi i LDK-së nuk ka ardhur në rend, pse ka ndodhur, është pritur tetë muaj për të njëjtën kërkesë, e tash për pesë ditë e kanë sjellë kërkesën për miratim?!

**Dren Kukaj**, drejtor, tha se sa i përket kësaj kërkesë nuk ka pasur ndonjë selektim, por problemi është se për shfrytëzimin e kësaj parcele kanë qenë të interesuara ndërmarrjet "Hortikultura" dhe "Trafiku Urban", dhe derisa kemi rënë në ujdi me këto ndërmarrje, për këtë arsye dhe është vonuar kërkesa e kompanisë "Pastrimi".

**Vlora Dumoshi** ngriti shqetësim rreth shpërndarjes së faturave për pagesën e mbeturinave në objektet e banimit, duke thënë se personat përgjegjës të cilët e bëjnë shpërndarjen e tyre, të jenë më të kujdesshëm që ato fatura t'i vendosin në vendin e duhur.

**Kryesuesi e hodhi në votim popozimvendimin.**

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortikultura".**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Shefki Gashi** tha se sa i përket dhënies së pronës në shfrytëzim kësaj ndërmarrjeje, e cila për dedikim ka mbjellje të fidanëve, por paraprakisht është dashtë të bëhet mirë definimi i pronës dhe të shikohet mirë se ajo pronë a i plotëson kushtet për atë dedikim.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se edhe në këtë propozimvendim nuk është specifikuar ashtu si duhet numri i parcelave, pra është dashur që të jenë të specifikuar saktë me metër katror.

**Vala Peshku** tha se në bazë të këtij materiali thuhet se parcelat të cilat janë përzgjedhur, janë afër sistemit rrugor të qytetit edhe janë afër sigurimit të furnizimit të rregullt me ujë, mirëpo ajo që më shqetëson, është se në materialin që e kemi thuhet: "... prandaj ne presim që vlera e fidanëve të prodhuar për një periudhë 10-20 vjeçare të jetë me fitime milionëshe". Kjo është vetëm fjali koti. Andaj, kërkoi që në të ardhmen, kushdo që sjell kërkesa, mos të vjen me kësi fjali se këto janë hajgare.

**Shefqet Osmani** theksoi se në kopje të planit të kësaj parcele nuk ka titullar dhe këtij materiali i është bashkëngjitur vetëm një kopje e planit për parcelën 1376, d.m.th. këtu mungon edhe një dokument, mungon edhe një kopje e planit për parcelën 1377. Si është e mundur që certifikata me pasur titullar e kopja e planit mos me pasur titullar?!

**Dren Kukaj**, drejtor, tha se sipërfaqja e cila jepet në shfrytëzim është e precizuar, ajo është 49.585 m<sup>2</sup> në total që nxirren prej dy parcelave, 1376-0 dhe 1377-0.

Sa i përket mungesës së kopjes së planit, ka shumë prona që nuk kanë kopje të planit. Mirëpo, gjithmonë e rëndësishme është nëse në regjistrat kadastralë titullari është i saktë, atëherë edhe prona është e saktë.

**Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.**

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 2 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortikultura".**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.**

**Mirsad Vitia**, kërkoi një sqarim nga ekzekutivi lidhur me numrin e parcelës, duke thënë se në kërkesën që është bërë nga kryeshefi ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" të parashtruar për Komunën e Prishtinës, numri i parcelës që kërkohet për shfrytëzim është në sipërfaqe prej 37293 m<sup>2</sup> kurse te propozimi, te arsyetime dhe te vendimi është 37239 m<sup>2</sup>.

**Shefqet Osmani** kërkoi një sqarim nga ekzekutivi lidhur me arsyetimin e vendimit, i cili tha se dhënia e pronës në shfrytëzim, sipas asaj që ceket në arsyetim, është e paqartë. Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

**Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 4 kundër dhe 4 abstenime, nuk u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.**

**Pika e nëntë**

**Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Vlora Dumoshi**, kërkoi nga të gjithë ata që janë pjesë e komiteteve, që t'i mbajnë mbledhjet e komiteteve dhe të dalin edhe me shqetësimet, por edhe ndonjëherë me punën të cilën drejtoritë e bëjnë, por pse jo edhe me lëvdata për drejtorët të cilët angazhohen. Lidhur me këtë e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, sepse gjatë kohës sa ishte greva në Arsim, në Komitetin për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport, drejtori i Drejtorisë së Arsimit na ka njoftuar rreth gjendjes së krijuar në Arsim si pasojë e grevës. Po ashtu, e falënderoj publikisht, sepse na ka sjellë edhe kryetaren e Këshillit të prindërve dhe arsimtarëve, i cili është organ shumë i rëndësishëm për shkollën, edhe kemi pasur një takim shumë konstruktiv për dy orë në këtë Komitet.

**Fiknete Bejta** theksoi se me sjelljen e këtyre dy raporteve të cilat ne sot po i diskutojmë, nuk besoj se ndonjë rezultat në këto i kanë shprehur si terma, por nuk kanë një lloj performance të rezultateve. Shqetësimet e banorëve janë të shumta, andaj këto shqetësime nuk mund të themi se janë trajtuar në këto raporte, siç janë p.sh. problemi në parandalimin e zhurmës në lokale të ndryshme, disa dukuri të tjera negative, si droga, prostitucioni etj. Gjithashtu, mos trajtimi i qenve endacakë, mos lirimi i hapësirave të uzurpuara, mungesa e subvencionimeve në rajonin e Gollakut etj., shqetësime të shumta të banorëve e që është dashur të trajtohen.

**Egzon Azemi** kërkoi të dijë se LVV-ja a ka të drejtë me e dërguar një anëtar në Komitetin për Komunitete, pasi që Valbona Petrovci ka qenë e propozuar prej LVV-së dhe tani ajo është asambliste e pavarur.

**Osman Bllaca** tha se këto dy komitete, Komiteti për Komunitete dhe KKSB-ja, janë të obligueshme dhe deri më tani i kanë mbajtur të gjitha mbledhjet, ashtu siç kanë qenë të parapara. Nuk është bërë diçka më shumë në Komitetin për Komunitete, por ato çka i kanë diskutuar, çka i kanë propozuar, i kemi sjellë si raport për t'i informuar anëtarët e Kuvendit.

Sa i përket propozimit për përfshirjen edhe të një anëtari nga LVV-ja, paraprakisht duhet me u shkarkuar Valbona Petrovci, pastaj mund të propozohet anëtari tjetër.

**Vala Peshku** tha se nuk është këtu vetëm LVV-ja që nuk e ka përfaqësuesin, por është edhe PSD-ja, por znj. Valbonë Petrovci pikërisht pse është e pavarur ndoshta është më së miri që të vazhdon të jetë anëtare e komitetit.

**Halim Halimi** theksoi se edhe ne si grup parlamentar kërkojmë që të plotësohet vendi i lirë në Komitetin për Zhvillim Ekonomik, meqenëse asamblistja, Fiknete Bejta, ka aderuar në AAK. Andaj ne për anëtar në këtë komitet propozojmë asamblistin Sami Salihu.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.**

**Pika e dhjetë**

**Diskutim për Raportin vjetor të punës së KKSB-së.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i punës së KKSB - së.**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për riemërtimin e SHFMU "Shkolla e Gjelbër".**

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për riemërtimin e SHFMU "Shkolla e Gjelbër, Remzi Salihu", SHFMU "Shkolla e Gjelbër, Shpend Canolli" ose SHFMU "Shkolla e Gjelbër, Sevasti Qiriazi".**

**Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim SHPI - KFOR-it, "Film City" në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim SHPI- KFOR-it, "Film City" në Prishtinë.**

## **Pika e trembëdhjetë Pyetje dhe përgjigje.**

**Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:**

1. Qytetarët dhe bizneset nuk pastrojnë borën para ndërtesave dhe bizneseve të tyre. A duhet Inspektorati i Shërbimeve Publike dhe Komuna fillimisht të shpërndajnë instruksione, pastaj të mirëmbajnë procesin e tyre?
2. Qytetarët dhe bizneset kur pastrojnë borën nuk e grumbullojnë në vende të caktuar, por borën e hedhin në rrugë, me çka shkaktojnë pengesa në komunikacion. A duhet të caktohen disa lokacione për grumbullim dhe largim të reshjeve të borës në periudhë dimrit?
3. Komuna duhet që ta shtojë angazhimet për të parandaluar emetimin -(ngrohje me mjete që ndotin ambientin) e gazrave që shkaktojnë ndotje marramendëse.
4. Kur do të bëhet përfundimi i punimeve të shkallëve në lagjen "Arbëria", si dhe a do të merren parasysh pasojat dhe ndërhyrjet anësore në rrugët e lagjes të cilat janë të përfshira në projekt, me theks të veçantë vendkalimi pranë QKMF-së në lagjen "Arbëria"?
5. Të bëhet sanimi i gropave dhe pusëve të rrugëve në lagje të ndryshme të qytetit:
  - Rruga "Bedri Shala" - Lagjja e Muhaxhirëve (puseta),
  - Rruga "Plava", lagjja "Arbëria",
  - Rruga për te stadiumi "Flamurtari" dhe nyjat përreth - lagjja "Bajram Bahtiri",
  - Rruga te shkolla "Ismaj Qemajli",
  - Rruga te Banesat e Bardha, e cila lidhet me rrugën "B",
  - Rruga "24 Maji", lagjja "Arbëria" (gropë) - si dhe rrugët përcjellëse të lagjes,
  - Rrugët në lagjen "Tophane", me theks të veçantë rruga e cila lidhë lagjet "Tophane" dhe "Qafa" te Bahollët dhe Ibërdemajt,
  - Lagjja "Pejton" në tërësi.
6. Të përmirësohet ndriçimi publik urgjentisht, duke u marrë masat adekuate, me theks të veçantë në lagjet të cilat gjenden pranë parqeve dhe maleve, si: Lagjja "Arbëria" (Parku i Arbërisë), Parku i Qytetit, si dhe "Toukbaçja".
7. Të bëhet vendosja e ndryshme e koeficienteve të ndërtimit nëpër lagje të ndryshme të qytetit, me theks të veçantë në Lagjen e Spitalit, si p.sh.: rruga "Malush Kosova", disa objekte të banim kolektiv lejohen të ndërtohen deri në 10 kat, ndërsa disa tjera deri në 6 kat, që realisht rrezikon disa objekte të mos ju bjerë dielli asnjëherë gjatë ditës.
8. Kur do të vazhdohet rruga "B", e cila parashihet të dalë te xhamia?
9. Të bëhet mirëmbajtja e parkingjeve të qytetit dhe funksionalizimi i tyre, si të parandalohen parkingjet e paplanifikuara të veturave në qytet, konkretisht në lagjen "Pejton", duke u mohuar e drejta elementare e banimit të qytetarëve të asaj zone?
10. Mirëmbajtja e banesave kolektive, konkretisht në lagjen "Ulpiana", ku në disa hyrje kundërmojnë ujërat e zeza, të cilat shkaktohen nga vjetërsia ose prishja e

gypave dhe kanalizimeve në ato banesa( ku qytetarët rrezikohen nga epidemitë e ndryshme individuale dhe kolektive).

11. Mirëmbajtja ose mbyllja e kontejnerëve të vendosur rishtazi në qytet, tek Raiffeisen Banka, te Policia, te Parkingu te Qafa, ngase kundërmimi dhe rreziqet për përhapjen e epidemive për banorët dhe bizneset për rreth tyre është evident në çdo kohë.

**Egzon Azemi, për Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës:**

Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë, është një qendër e cila fatkeqësisht tash për tash është në gjendje shumë të mjerueshme, për shkak që financimi paraprakisht ka ndodhur prej Komunës së Prishtinës. Për disa arsye deri diku të bazuara, i është ndaluar financimi, mirëpo kur kemi parasysh se aty është ndërruar drejtoresha dhe bordi, kjo tash nuk financohet as nga Komuna e Prishtinës, as nga Ministria, dhe aty ka një numër të konsiderueshëm të grave jo vetëm të komunës së Prishtinës, por edhe të disa komunave tjera, pra të grave dhe fëmijëve. Prandaj, fillimisht kisha kërkuar me mbështetur një iniciativë të disa të rinjve të Prishtinës, që kanë kërkuar nga qytetarët e Prishtinës, që dhuratat të cilat i kanë planifikuar me ia bërë bashkëshortit, partnerit që janë në lidhje, më 14 shkurt, por fondet që i planifikojnë për këto dhurata me ia ndarë kësaj qendre. Kisha kërkuar edhe nga nënkryetari Pacolli, me na dhënë një zotim që me shikuar gjendjen e kësaj qendre fillimisht, pastaj me dalë me një zotim me sa euro në muaj kishte mundur Komuna me ndihmuar këtë Qendër, sepse aty përfundojnë gratë që pësojnë dhunë në familje, bashkë me fëmijët e tyre. Kështu që është një çështje e ndjeshme, me të cilën besoj se duhet me u marrë si Kuvend, por edhe si Komunë.

**Suzan Kika, për Selim Pacollin, nënkryetarin e Komunës, dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

1. Ditë më parë në emisionin e KTV-së, që i kushtohet Prishtinës, e pash se Unaza nuk do të fillojë edhe këtë vit, e që ky është një shqetësim, sepse si Prishtinë jemi të ngufatur pikërisht nga një infrastrukturë rrugore, e cila nuk po ka kapacitet me e përballuar gjithë këtë fluks trafik, në veçanti qendra e Prishtinës dhe lagjet e vjetra, prandaj zvarritja e fillimit të ndërtimit të unazës vetëm sa po e vënit shpresën e zgjidhjes së këtij problemi. Prandaj, pyetja ime është për kryetarin e Komunës:

Pse po zvarritet ndërtimi i Unazës, a nuk ka mundësi të ndajmë mjete pjesërisht, apo të fillojë të ndërtohet ky segment i rrugës.

2. Kërkesë tjetër është nga prindërit e shkollës "Elena Gjika" që të gjejnë një zgjidhje për parkingun afër shkollës, ngase po e pengon lëvizjen e lirë të nxënësve dhe po e rritet pasiguria afër shkollës, duke e bllokuar pamjen.

3. Banorët afër rrugës "Lekë Dukagjini", në hyrjen SU- 6/2 dhe SU-6 /3, kanë probleme të jashtëzakonshme nga shoferët e papërgjegjshëm që bllokojnë hyrjet. Ata kërkojnë të ndërmerren masa nga ana e Komunës, dhe njëkohësisht kërkojnë ndriçim për këtë lagje.

3. Po ashtu, është kërkesë që nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të bëhet shenjzimi i rrugëve, e veçanërisht në rrugën "Zagrebi", në lagjen "Arbëria", te shkallët e Arbërisë.

**Vlora Dumoshi, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe për z. Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës:**



1. Një shqetësim i madh për një komunitet shumë të rëndësishëm, siç është "Sindrom Dauwn", që është një organizatë ku me vite të tëra ka pasur mbështetje nga Komuna e Prishtinës, edhe në kohën kur kamë qenë drejtoresh e Drejtorisë së Kulturë, Rini dhe Sport, dhe me Drejtorinë e Shëndetësisë, direkt me kryetarin e kemi mbështet këtë organizatë. Para dy viteve kësaj organizate i është ndarë një parcelë për ndërtimin e një ndërtese për plotësimin e kushteve të atyre fëmijëve për aktivitetet që i bëjnë. Po ashtu, janë organizuar dy apo tri takime humanitare, ku ka pasur derdhje të të hollave për këtë kategori, por për një informatë të cilën e kam, vetëm një person i ka dhënë 150 mijë euro.

Çka është duke ndodhur, pse nuk është proceduar kjo në tender për ndërtimin e këtij objekti?

**Bujar Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, tha se unë për këtë çështje kam marrë pak njohuri. Për aq sa kam njohuri mund të përgjigjem, sepse vonë jam kyçur në këtë drejtori, kështu që sa për informatë, është një bashkinvestim që TIK e ka marrë për investim.

**Vlora Dumoshi** theksoi se shqetësimi më i madh është se pse me e marrë TIK. Komuna e Prishtinës bashkëfinancuese, ka mjete për t'i financuar këto organizata, nuk është shkollë e as ndonjë objekt i madh. Unë e shoh me një shqetësim shumë të madhe investimin e TIK-ës në komunën e Prishtinës, sidomos te pjesa e Hamamit dhe te pjesa e Xhamisë së Mesme dhe ky investim nga TIK-ja do të na kushtojë shumë. Ne e kemi rastin e shkollës fillore "Elena Xhika", ku TIK-ja pasi e ka bërë lysterjen e shkollës, në për çdo klasë kanë vënë flamuj turk dhe e kanë hequr foton e Skënderbeut. Ndërsa sa i përket renovimit të Xhamisë së Çarshisë, ajo ka mbetur për 20 mijë euro pa u rinovuar.

**Selim Pacolli**, nënkryetar, tha se "Sindrom Dauwn", është një kategori e shoqërisë tonë, që është tejet e rëndësishme, dhe besoj që nuk kemi pasur ndonjë komoditet që të lëshohemi në atë nivel, sa që t'i investigojmë investitorët e mundshëm kushdo qofshin ata. Ne nuk jemi këtu që kemi një digaster të hetuesisë se kush janë TIK-a, çfarë përbën TIK-a, pra ne kemi një donacion prej tyre. Çështja e Hamamit dhe e Xhamisë së Çarshisë, konkretisht Hamami nuk i plotëson kushtet dhe kriteret që të jetë si monument kulturor, pasi që nuk është rinovuar ashtu si duhet.

Sa i përket Unazës së jashtme, apo për rrugën A. Unaza e jashtme neve tash na dalin edhe pjesë të tjera, që sipas kalkulimeve nuk janë në pyetje 60 milionë euro, mirëpo shkon në 137 milionë euro, sepse në atë projekt nuk janë paraparë shpronësimet, është kalkuluar vetëm kostoja. Këto 60 mijë euro do t'i shfrytëzojmë vetëm për segmentin që i mbulojnë këto mjete.

#### **Shefqet Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:**

Banorët afër rrugës "Bajram Bahtiri" deri te ish-kazerma e ushtrisë, kanë shqetësim nga një rrezikshmëri, në veçanti për fëmijë, mungesën e trotuarit për këmbësorë. Por, rrezikshmëria më e lart është te një shtëpi tri katëshe, afër pompës "Nasa Petroll", buzë rrugës, e cila është e lakuar për 4 metra dhe i ngjan kullës së Pizës. Kërkoj nga ekzekutivi i Komunë, pra bëj apel te kryetari dhe nënkryetari që të marrin masa për rrëzimin e kësaj shtëpie.

#### **Sami Salihu, për Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës:**

Para dy muajve, me një mund të madh arritëm ta shpëtojmë Sport Marketingun nga falimentimi, ku dhe ne votuam për ndarjen e mjeteve në shumën prej 130415, 00 mijë euro,

shumë kjo e cila do t'i kryente detyrimet e saj, si borxhet për paga të punëtorëve, borxhet e pagave të ish-bordit, borxhet ndaj furnitorëve dhe borxhet ndaj ATK-së, andaj ne si LDK kërkojmë nga aksionarët, apo nga drejtoresha e kësaj ndërmarrje, që në seancën e radhës të na informoi se a janë kryer të gjitha detyrimet e kësaj ndërmarrje për të cilat Komuna i dhuroi këto mjete, nëse jo, atëherë përse.

**Leonora Shabani - Bajraktari**, sa i përket "Sindrom Douwn" dhe Shoqatës me Autizëm, tha se në vitin 2015 i patëm organizuar dy mbrëmje bamirësie, ku janë mbledh fonde përmes telefonatave, përmes vullnetit të qytetarëve mbi 200 mijë euro. Dhe ky organizim ka qenë jashtëzakonisht i suksesshëm dhe organizata "Sindrom Dauvn Kosova", bashkë me Shoqatën e Autizmit, veç i kanë pasur fondet për ndërtimin e atij objekti, ku do të ofrohen shërbime për fëmijë me Sindrom Dauwn dhe me autizëm. Ka shkuar pak si zvarritur kjo çështja e parcelës dhe në fakt tash veç është marrë vendimi sa i përket parcelës që është ndarë për organizatën "Sindrom Dauwn", po ka pasur diçka si keqmenaxhim i prokurimit sa i përket ndërtimit të asaj qendre dhe tash i ofrohet organizatës TIK. Unë kisha thënë që mos të jetë vetëm TIK si ndërtuese apo donatore, por të jetë bashkërisht me Komunën.

**Eman Rrahmani, për Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës:**

Në mbledhjen e fundit i kemi kaluar dy pika pa dëshirën tonë, por për shkak të një pozicioni të palakmueshëm që na keni qitur, i kemi alokuar mjete Pallatit të Rinisë dhe 20 përqindëshin për ish-punëtorët e Tjegullores. Ato mjete nuk kanë kaluar në vendin e duhur, sepse Ministria i ka kthyer si të paligjshme. Ne ju treguam se jeni duke vepruar jashtëligjshëm. Ata punëtorë tash përveç se ndihen të mashtruar nga ish-koha e mëparshme, ata ndihen të mashtruar edhe nga ne, se ju kemi premtuar se do t'i marrin ato mjete qysh në fillim të vitit, kështu që ndoshta kishte me qenë mirë me e kërkuar një falje publike që na keni detyruar me votuar, sepse ne veç ju patëm paralajmëruar se ai veprim është kundërligjor dhe nuk mundet me kaluar.

**Selim Pacolli** tha se neve nga Ministria na u ka kthyer jo si pasojë e ligjshmërisë, por se ne nuk kemi arrit me kohë që ta procedojmë në Thesar, në Ministrinë e financave. Pra ne nuk kemi arritur me kohë dhe përgjigjen e kemi prej Ministrisë për shkak të mbylljes së Thesarit dhe se deri në miratimin e buxhetit nuk mundet me u proceduar pagesa. Unë besoj se pas miratimit të buxhetit do të bëhet një zgjidhje, pra është çështje e punëtorëve që ju takon atyre.

**Mirsad Vitia, për Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, dhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit**

1. Pyetja që ka të bëjë me transport, është për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, ku në një konferencë që kemi marrë pjesë, kemi qenë katër asambleistë dhe drejtori, z. Jonuz Salihaj, ku në atë konferencë është debatuar për fletënotimin komunitar në gjithë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim. Më konkretisht, bëhet fjalë për prindin Hazir Mehmeti nga Bardhoshi, prind i fëmijës, Riadit, me aftësi të kufizuara, i cili kishte bërë kërkesë për transport që t'i mundësohet nga Drejtoria e Arsimit për relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, mirëpo nuk kishte marrë përgjigje, edhe pse Komuna i kishte premtuar përgjigje.

2. Pyetja tjetër ka të bëjë me infrastrukturën, ku më 13 shkurt 2018, unë, z. Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, u kemi bërë vizitë disa pjesëve të lagjes Hajvalia, ku e kemi parë edhe gjendjen e rrugëve dhe rrugicave të

Hajvalisë, ku disa prej tyre kanë përfunduar e disa kanë ngel në proces e sipër. Ndër të tjera është edhe lumi, i cili lidhet kah brendësia e fshatit, do të thotë që shkon drejt banesave të "Swis Daimond" në kryqëzim me rrugën "Bejtë Vitia" deri aty ka vazhduar mbulimi i lumit, dhe u bë një rrugë shumë e mirë

A mund të vazhdojë kjo rrugë edhe poshtë dhe kur do të mund të ndërtohet?

**Selim Pacolli** tha se aty për shkak të kushteve atmosferike janë ndërprerë punimet, në segmentin e poshtëm afër magjistrales për Gjilan. Por, ne aty e kemi një kontest pronësor me një banor të Hajvalisë, me një të familjes Sopiani, dhe lumi ka mbetur të lidhet deri në fund me lumin Graçanka. Më se 80 rrugë dhe rrugica janë shtruar, por duhet kohë për me i vazhduar edhe të tjerat. Me fillim të sezonit do të fillojë edhe ky projekt.

**Suzan Kika, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit.**

Në një konferencë mbajtur nga "Hendikos" një prind i dy fëmijëve të sëmurë, njëri me kancer e tjetri me autizëm, ngriti një shqetësim rreth vijueshmërisë së fëmijëve në shkollën e autizmit. Ajo kërkoi që t'iu mundësohet vijimi i mësimit pa pagesë në këtë shkollë.

**Leonora Shabani - Bajraktari**, sa për sqarim ceku se, sa i përket shoqatave që i trajtojnë fëmijët me autizëm, është e vërtetë që aty prindërit duhet të paguajnë një shumë të mjeteve prej 100- 150 euro, pra varet se sa seanca dëshiron me i mbajtur gjatë javës, për arsye se shpenzimet e atyre organizatave nuk mbulohen, dhe tash për me ju ofruar shërbime duhet me paguar, gjë që me të vërtetë është një shumë jashtëzakonisht e madhe.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi



Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta